

L I G J
PER PLOTESIMIN E LIGJIT PER QEVERINE E REPUBLIKES SE MAQEDONISE

Neni 1

Ne Ligjin per Qeverine e Republikes se Maqedonise ("Gazeta Zyrtare e Republikes se Maqedonise" numer 59/2000, 12/2003, 55/2005, 37/2006, 115/2007, 19/2008, 82/2008, 10/10 dhe 51/11), pas nenit 14 shtohet nen i ri 14-a, si vijon:

"Neni 14 - a

Kryetari i Qeverise se Republikes se Maqedonise te cilit i eshte nderprere funksioni ka te drejte per sigurim personal prej gjashte personave te punesuar ne njesine organizative per sigurim te personave dhe objekteve ne Ministrine e Puneve te Brendshme, si dhe te drejte per shfrytezim te vetures zyrtare dhe shoferit.

Personat nga paragrafi 1 i ketij neni, zgjidhen nga Kryetari i Qeverise se Republikes se Maqedonise te cilit i eshte nderprere funksioni.

Kryetari i Qeverise se Republikes se Maqedonise te cilit i eshte nderprere funksioni, te drejten nga paragrafi 1 i ketij neni e realizon ne periudhe te njejte me periudhen e kohezgjatjes se kryerjes se funksionit kryetar i Qeverise se Republikes se Maqedonise dhe fillon ta realizoje nga dita e nderprerjes se funksionit.

Kryetari i Qeverise se Republikes se Maqedonise i cili e ka kryer funksionin me pak se nje vit, te drejten nga paragrafi 1 i ketij neni e realizon ne periudhe prej nje viti nga dita e nderprerjes se funksionit."

Neni 2

Ky ligj hyn ne fuqi ne ditën e tete nga dita e botimit ne "Gazeten Zyrtare te Republikes se Maqedonise".